

VENDIM
Nr. 12, datë 13.1.2022

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 290, DATË 11.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHETETËRORE TË SISTEMIT INFORMATIK TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR (SIPI/IPSIS)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 7 e 8, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 290, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas nënndarjes së parë “- Paketa Kombëtare e Projekteve Strategjike;”, të shkronjës “dh”, të pikës 3, shtohet nënndarja e dytë, me këtë përmbajtje:

“- Paketa Kombëtare e Projekteve;”.

2. Në shkronjën “c”, të pikës 4, fjalët “... ministrisë përgjegjëse për financat ...” zëvendësohen me emërtimin “Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”.

3. Në shkronjën “b”, të pikës 8, fjalët “... ministria përgjegjëse për financat ...” zëvendësohen me emërtimin “Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”.

4. Në pikën 10 dhe kudo në tekst, fjalët “... njësia përgjegjëse për sistemet e mirëqeverisjes në Kryeministri ...” zëvendësohen me emërtimin “Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kryeministria dhe Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj